DRAFTI I

RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

TE AKTIVITETIT:

"Impiant betoni"

Subjekti: " Trema Engineering 2 " sh.p.k

Vendndodhja: Komuna Rukaj,Rrethi Mat, Qarku Diber

Tirane, 2015

PERMBAJTJA

- **Hyrje**
- **Baza ligjore**
- **Metodika e vleresimit te mjedisit**
- **Objektivat dhe qellimi i VNM-se**

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe "produkte" qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proçes. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

"Impiant betoni"

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011* ***" Per Mbrojtjen e Mjedisit"***
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011* ***« Per Lejet e Mjedisit »***
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011* ***« Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »***
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007* ***"Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes"***
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007* ***"Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara"***
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003* ***"Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta"***
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002* ***"Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja"***
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011* ***"Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"***
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003* ***« Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »***
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996* ***« Per largimin publik te mbeturinave »***
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009* ***« Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »***
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009* ***'Per metodologjine e raportit te VNM'***

- *VKM nr.419 date 25.6.2014 «* ***Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».***
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013* ***" Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis".***

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➢ ***Profili i propozuesit***

Subjekti **"Trema Engineering 2 "sh.p.k** do te ushtroje aktivitetin per impiant betoni. Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore.

Pershkrimi i qellimit te propozuar

- **IMPIANTI BETONI**

1-Impianti I betonit
Kombinati CIFA 1 Per pregatitjen e Betonit te tipit Personal 4 WET 2000/s
- VERSIONI SKIP
Karakteristikat kryesore:
.- nxjerrja teorike e betonit sipas DIN459, pjesa 1 80 m^3/ore
(sipasnormes DIN 1045)
- nxjerrja per ngarkese me beton kompakt 2,00 mc
- numril agregateve 4
-ruajtja teorike e agregateve 180m^3
-ngarkesat me peshe
peragregate, ngarkesamaksimale 10000 kg
per cimento, ngarkesa maksimale 1000 kg
per uje , ngarkesa maksimale 750 kg

-Ngarkes e lengu shtese sipas volumit dhe peshes
-Lartesia e shkarkimit te betonit 4.1m
-tipi i kontrollitmanual ose automatik
-tensioni i funksionimit400 V -50 Hz

I/ NJESIA E RUAJTJES DHE NGARKIMIT TE AGREGATEVE

Set i plote i mureve anesore dhe i mureve ndarese per 180 m^3, kapacitet ruajtes se agregateve ne 4 ndarje.

Skelet celiku rezistent per njesine e agregateve, mbrojtje me galvanizim tenxehte, duke perfshire portat e ngarkeses dhe te peshuarit dhe rripin transportìer, i pershtatshem per instalimin e mureve anesore dhe ndarese me kapacitet maksimal ruajtje,180m^3 te ndara ne 4 kompartimente.
Kater porta ngarkese me galvanizim te nxehte, te pershtatshme per agregatet e shtypur apo te rrumbullaket me kokrriza me permasa standarte deri ne 40 mm.Porta ngarkese qe funksionojne ne menyre elektròpneumatike me 4 cilindra, me valvul solenoidi me veprimte dyfishte dhe shkarkese te shpejte, instaluar prane cilindrave dhe pozicion i hapjes i rregullueshem. Te gjitha portat jane te pajisura me pllaka sigurie per te shmangur rrjedhjen e materialit jashte gorgul1es peshuese gjate mbylljes se portave.
Dy pllaka vibruese ne dy ndarjet e reres per te lehtesuar rrjedhjen e reres *(Ne total* 4 p*llaka vibruese te instaluara).*
Gorgull peshuese per agregatet me nje volum uji prej 7000 litrash per te ngarkuar deri ne 3 m3 .

Dy vibratore elektrike te pershtatur poshte dy ndarjeve te reres jashte gorgulles peshuese per nje shkarkim telehte.
Trashesia e pllakave te celiku
Muret anesore dhe ndareset:4mm
Portat ngarkuese:6mm mbyllese :l0mm
Ngarkuesi iagregateve :4mm

Njesi peshuese elektrorike per agregate me kapacitet total prej 10.000 kgme ane te 4 qelizave ngarkuese , mekonform normave KE dhe me ngarkese maksìmale prej5000 kg secila.- Njesì matese dhe indìkator dixhital te instaluara ne bordin e kontrollit.
Nje . Rrip transportier per peshimin dhe terheqjen e agregateve - gjeresi 800 mm, Distance qendrore 10,0 m-kapacitet transportues 320 m3 /ore -Fuqi e motoritelektrik 15 kW.

Karakteristika te transportierit:
Strukture e galvanizuar. Rrip gome i tipit 3l5(mbulese e siperme 3 mm - mbulesa eposhtme 2 mmme dy inserte polyester/nailon . Trashesi totale 6.6 mm). Cikrik drejtues i mbuluar me gome per te shmangur rreshkitjen; Cikrik i pasme me nje mjet geryese rregullueshem per nje pastrim me te mire te shiritit. Kushineta te siperme te tipit 3seksionesh,te grasatuara ne menyre te vazhdueshme dhe te vendosura ne distance 400mm. midis akseve·. Kushineta te poshtme me spirale pastruese te pershtatura ne 2 mdistance. 'Rripi ka nje rrjete mbrojtese anesore dhe nje ndalim emergjence me kavo ne te dyjaanet

o. Njesia pneumatike:

Nje Kompresor me dy faza.thithje e ajrit 670 l/min.; kapacitet depozite 270 lmenje filter vaji, rregullator presioni, sistem drenimi me kondensim dhe motorelektrik 3x 3 kw.
Njesi pneumatike per te cIintar ajer te presuar'te valvulat solenoidale me anete nje filtri, valvul e reduktimit te presionit ,manometer dhe lubrifikues. Ky jepet i para-mbledhur ne njesine e agregateve.
Fabrike pneumatike me ane te linjave te tubave dhe te pershtatjes se tubave nepikat e shumta te perdorimit.

II- PAJISJE NGRITESE ME KOSH PER AGREGATET PER TEUSHQYER PERZIERESIN

Nje kosh ngrites me shkarkim nga poshte , per te ngritur agregatet engarkuara dhe per te ushqyer perzieresin.-Kapaciteti 3.500 litra , -Shpejtesi ngritese/zbritese 24 m/min.-I plotesuar me shina dhe celesa kufizimi per te kontrolluar koshin"poshte" "prit","larte" dhe celes i urgjences perpozicionin "shume i larte " dhe "litar i lire", - Motor me pauze automatike 22kw -menyre ngritjeje ortogonale me aksin ekoshave lineare te agregateve.

III PLATFORME MBESHTETESEIPERZIERESE

Konstruksion ceIiku tip vincure rezistent projektuar per te mbeshteturgorgullen (hinken) pritese per leshuesin e agregateve, cimentos dhe ujit dheperzieresin icili mbeshtetet mbi kater me dysheme mbeshtetese pershtatur me nje ure per lartesi me doreza per mbeshtetjene perzieresitdhe njesive ngarkuese. Structura prej celiku per te mbledhur gorgullen pritese te agregateve, peshuesine cimentos dhe ujit. Me shkalle per t'u ngjitur nga toka.Lartesia e shkarkimit te betonit 4.1 m nga niveli I tokes.

IV/ NJESIA E NGARKIMIT TE CIMENTOS

Koshi per peshimin e cimentos i formuar per shkarkim optimal dhe i pajisurme vibrator elektrik dhe me valvule shkarkimi e kotrolluar ne menyreelektropneumatike me flutur te veshur me poliuretan dhe nje guarnicion gome.Kapacitet i koshit peshues 1.500 litra per t'u ngarkuar deri ne 1.200 kg.

Njesi peshimi elektronike me kapacitet 1.000 kg me ane te 3 qelizave ngarkuese me konform normativave te te KE dhe me ngarkese maksimale 1.500 kg secila.Njesimatese dhe indicator dixhital te instaluara ne bordin e kontrolIit. Njesi pneumatike per te cuar presionin e ajrit ne njesite e fluidizimit ose te filtrat,e pajisur me filter,manometer per reduktimin e presionit(jo ajer I lubrifikuar).Lubrifikues per dergimin e ajrit ne valvulen flutur.

V- NJESIA E NGARKIMIT TE UJIT

Koshi per peshimin e ujit, volum 600 lit teresisht i galvanizuar , i plotesuarme valvula ushqyese dhe shkarkuese prej solenoidi qe funksionojne ne menyre elektropneumatike. Njesi peshimi elektronike me kapacitet 600 kg, me ane te nje qelize ngarkuese konfom normativave te KE dhe ngarkese maksimale 1.500 kg secila- Njesi matese dheindicator dixhitaI te instaluara ne bordin e kontrollit.

VI- FILTER AJRI PER SHKARKIMIN E PERZIERESIT

I instaluar mbi perzieresin dhe perfshin:Mjet pastrues permjet vibrimit shkundes, filter tekstili siperfaqe filtruese 12 m^2.

VII-NJESIA E PERZIERJES

Perzieres i detyrueshem me bosht te dyfishte i tipit *3000/2000* Perzieres idetyrueshem me bosht te dyfishte me dy zona perzierje me ane teboshteve te sinkronizuara me kunder rrotullim.-Dhome perzierje e veshur me pllakarezistente ndaj gerryerjes te zevendesueshme..-. Krahe perzieres te zevendesueshem temberthyer ne boshtet perzieres. -Lopata perzierese te rregullueshme dhe tezevendesueshme te derdhura ne hekur Ni-Cr rezistente ndaj gerryerjes.-N.2 motorreelektrike me rrip transmisioni.-V dhe kuti ingranazhesh te lidhura me nje vaske

vaji.Guamicionespeciale te boshtave me njesi automatike grasatimi e plotesuar medepozite grasoje dhe me indikator per renien e nivelit.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

- **Pozita gjeografike**

Qarku i Dibrës bën pjesë në rajonin veri-lindor me një reliev përgjithësisht kodrinor-malor.Pra shtrihet në Veri-Lindje të Shqipërisë në dy anët e luginës së Drinit të Zi duke u kufizuar në lindje nga vargmali i Korabit dhe në perëndim nga vargmalet e Lurës. Qendra e rrethit është qyteti i Peshkopisë.Qendra e rrethit (Peshkopia) shtrihet 185 km nga kryeqyteti dhe 21 km largësi nga pika e doganës së Bllatës në Maqellarë.

Ky rreth është vendosur në këto koordinata gjeografikë:41° 53’ 20”,dhe 41° 33’ 40” gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 34’ 50” dhë 20° 07’ 00” gjatësi gjeografike lindore.Kufizohet nga kufinj konvencionale në lindje më republikën e Kosovës dhe të Maqedonisë me një gjatësi kufitare 90 km nga të cilat 19 km janë lumorë.Në veri kufizohet me rrethin e Kukësit me 75 km vijë kufitare.Në perëndim me Mirditën 13 km vijë kufitare dhe me rrethin e Matit me 60 km vijë kufitare.Në jug me Bulqizën 27.8 km vijë kufitare

Ky rreth ka një ndërtim të komplikuar gjeologjik që është kapur herë pas herë nga lëvizjet neotektonikë ngritëse që ka luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e relievit.Rrethi i Dibrës ka një reliev kodrinor-malor që varion nga 350 m (lugina e Drinit të Zi) deri në 2751 në majën e Korabit.Bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare malore dhe mesdhetare para malore meqenëse është pjesë përbërëse e pellgut të Drinit të Zi.Ka një hidrografi të pasur me burime mbitokësore dhe nëntokësore ku dega kryesore është Drini i Zi.Dibra dallohet për shumëllojshmërinë e tokave të cilat për shkak të relievit malor shprehen qartë.Gjejmë brezin e tokave aluvionale rreth lumit të Drinit të Zi, të kafenjta, të murrme pyjore dhe atë livadhore malore.Në këtë takojmë breza bimorë si: brezi i dushqeve, ahut dhe haloreve dhe kullotave alpine.Ky rreth ka një popullsi prej 75000 banorësh të vendosur në 1088 km˛ kryesisht në vendbanime të rralla e rurale. Nga pikëpamja administrative ky rreth ka në përbërjen e tij 1 bashki (bashkinë e Peshkopisë) dhe 14 komuna.

- **Kushtet klimaterike**

Rrethi i Dibrës bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare malore dhe atë mesdhetare para-malore meqënëse është pjesë e pellgjeve të lumenjve të Drinit. Dallohet për ndryshime të dukshme nga një sektor në një tjetër sidomos në drejtimin vertikal.Në formimin e kësaj klime kanë ndikuar faktorë si:lartesia dhe relievi i territorit,ndikimi i madh i klimës kontinentale nëpërmjet erave që vijne nga grykat dhe qafat nga brendesia e ballkanit.si rezultat kjo klimë dallohet për klimë të ashpër ,dimër të gjatë dhe reshje të mëdha te dëbores dhe verë te freskët por pa reshje. Temperatura mesatare shkon nga 6 ° C në malin e Korabit ne 11 ° C ne afersi te luginës.Po ta krahasojmë me temperaturen mesatare te vendit tone ajo leviz nga 4°-8° C kuptohet që shkaku kryesor është lartesia mbi nivel të detit dhe pozicioni i saj lindor që kushtëzon një ndikim nga brendësia e ballkanit.Në periudhën prill-shtator temperatura mesatare është 16° C në afërsi të qytetit Për muajin korrik temperatura mesatare shkon nga 7 ° C në pjesë të larta dhe 16 ° C ,në afërsi të luginës .Muaji janar është muaji me i ftohtë i vitit ku mesatarja shkon nga 0° C ne -3° C. Amplituda e temperatures vjetore merr vlera jo të vogla që shkojnë rreth 17° C-18° C. Kurse amplituda ditore shkon deri 10-15° C ,temperatura maksimale e zonës është rregjistruar në korrik të 1996 në qytet 39.5° C kurse ajo minimale është rregjistruar në 1959 kur ka arritur -20° C amplituda midis vlerave është relativisht jo e vogël që shkon 60° C .Për sa i perket sasise së rreshjeve zona futet ne zonat nën masataren së vendit. Kjo vlere shkon nga 900 mm (në Qarrishte)ky ndryshim lidhet me deporimin e erave te ftohta e te thata .Pjesa më e madhe e tyre është e përqendruar në pjesen e ftohte te vitit,90 %, kurse në pjesen e ngrohte bin rreth 10-15%. Muaji me i laget eshte nendori me 12% të rreshjeve afro 225 mm,kurse muaji më me pak reshje është korriku me 3.6% ose 46 mm .Maksimumi i reshjeve ne 24 ore ka qënë 127 mm .Per reshjet e debores mund të themi se fillojnë msatarisht me 1 nendor dhe data e mbarimit është 20 mars.Numri mesatar i ditëve me borë shkon 38 dite dhe krijon një shtrese mesatre prej 30-35 cm. Shtresa maksimale shkon 1.5m në shpata te malit.

- **Relievi**

Relievi i zonës është malor dhe dallohet për karakterin kompleks në përbërje te relievit gjejmë: kurrize malore,pllaja,gropa,fusha karstike si dhe malësi e lugina. Kjo malësi shtrihet nga 380-2751 m në skajin lindor pra amplitude hipsonometrike është e madhe ,mbizotrojnë malësitë mbi 700-900m qe ulen gradualisht në drejtim te perëndimit. Coptimi horizontal i relievit në këtë zonë është i madh dhe shumë i madh ne terrigjenet e vjetër dhe te rinj dhe i vogël dhe shumë i vogël në gëlqeroret. Relievi akullnajor ka shtrirje të cilën e gjejmë vetëm ne pjesë te larta si majat e

maleve që kanë përbërje gëlqerore. Gjejmë edhe lëndina me peisazhe piktoreske si fusha e Korabit,bjeshkët e Shehut të cilat janë të ralla për nga vlerat ekonomike.

- **Gjeologjia**

Ndërtimi gjeologjik në këtë reth mundëson zhvillimin pasi kjo zonë është e pasur me minerale, lende ndërtimi dhe mermerë. Ky ndërtim gjeologjik ka bërë që vendbanimet të vëndosen kryesisht në përbëriet gëlqerore dhe në kontaktet me shtresa të tjera për arsye të burimeve hidrike. Përbërja me argjila dhe gëlqerorë ka bërë që edhe oferta të jetë shumë e pasur per ta.Duhet theksuar se per sa i përket relievit në vendosjen e vendbanimeve dhe ndikimin e tij në zhvillimin social-ekonomik ai ka ndikuar në karakterin e një ekonomie të mbyllur dhe me drejtim në degën e blegtorisë pasi oferta e tokave pjellore bujqësore është e kufizuar. Relievi ka qënë përcaktues edhe në arkitekturën e ndërtimeve dhe mënzres së jetesës në zona të izoluara. Ky reliev ka përcaktuar edhe vendosjen larg njëra-tjetrës të pronave të banuara duke lënë të lira tokat prodhuese. Ky rajon ka mundësi te mëdha për zhvillimin e turizmit.Peizazhe piktoreske ofron edhe parku kombëtar i Lurës si dhe pyjet e shumta,liqenet që janë shumë të bukura.

- **Flora dhe fauna**

Larmia dhe pasuria qe ka kjo zone si ne aspektin klimatik , ate te tokave, te flores etj ka krijuar kushte shume te favorshme per zhvillimin e nje bote shtazore e bimore shume te larmishme. Kete gje e deshmon ekzistenca e shume specieve te vecanta sipas karakterit te habitatit. Do te dallonim boten bimore te shkurreve, te pyjeve te ahut dhe te dushkut;si dhe ne lartesi boten interesante te kullotave alpine dhe te pak habitateve ujore. Ne habitatet e shkurreve qe jane me pak te zhviiluara e me pak te perhapura dhe te degraduara nga dora e njeriut gjejme: Lepuri i eger, cakalli, thelleza, dhe nje sere shpendesh te tjere.Ne habitatet e dushkut qe edhe ky kat eshte I demtuar takohen rralle: Ujku, dhelpra, ketri, urithi, etj. Ne habitatet e pyjeve te ahut dhe te pishes qe jane me te dendura dhe me pak te prekura nga dora e njeriut takohen specie te vecanta: Ariu, Shqiponja, Rrjepulli, miu vogel, urithi, etj.Ne habitatet e ujrave te kthjelleta dhe te ftohta te ketyre lumenjve takohet trofta e eger dhe disa lloje te tjera peshqish cka e ben kete zone te dallueshme nga zonat e tjera te vendit. E gjithe kjo ,pasuri e botes shtazore dhe me vlera te vecanta ofron kushte per zhvillimin e disa llojeve te turizmit si : sportive, ekologjik, c'lodhes,

- **Hidrografia**

Ky rreth ka një rrjet hidrografik shumë të pasur qe përbëhet nga lumaj,liqene përrej, burime nën tokesore dhe mbi tokësore. Dega kryesore është lumi i drinit të ziqë merr me vete disa degë të tjera si:Malla,Seta,Veleshica,Murra etjer. Këta degë kane karakter të vrullshëm dhe me prurje të mëdha në kohën e shkrirjes së borës. Gjë që i bën ata të jënë shumë të demshëm dhe të shkatërrojnë çdo gjë që u del para duke sjelle shumë materiale të ngurta e shkaktuar përmbytje të tokave përeth.

- **Gjatësia dhe pellgu janë përkatësisht:**

Drini zi 57 530km

Murra 19 135km

Malla 18 126km

Seta 13 137km

Veleshica 15 84km

Midis pasurive të shumta vlen për të përmendur edhe liqenet shumë të bukura të Lurës,burimin e llixhave si edhe disa burime të vogla në afërsi të qytetit,pasuritë hidrike.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikisht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

- **Ndikimet ne toke**

Mbetjet teknologjike jane fraksione te imeta nga linja e prodhimit te betonit(mase e imet) qe varion 1- 1.5 % e sasise se lendes se pare te perpunuar. Kjo mase eshte ne sasi teper te vogel sistemohet dhe riperdoret nga zona. Mbetje me fraksion mbi 20 mm e linjes se fraksionimit, e cila perdoret per mbushje dhe rilevime te territorit. Kjo sasi mbetje eshte 5-10 % te sasise se lendes se pare te perdorur.

- **Ndikimet mbi popullsine**

Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk ka ndikime negative mbi popullsine perreth, pervecse zhvillimi i ketij aktiviteti do te sjelle punesimin e disa baroreve perreth duke kontribuar sadopak ne rritjen e mireqenies ne zone perreth.

- **Ndikimet ne cilesine e ajrit**

Persa i perket shkarkimeve ne ajer nga zhvillimi i aktivitetit nuk emetohen gaze te demshem ne atmosfere per mjedisin apo banoret e zones perreth. Referuar natyres se procesit nuk kemi sasi

gazesh te shkarkuar ne atmosfere, por vetem pluhur . Per te minimizuar kete ndikim negativ eshte bere nje izolim ne pjesen e daljes se mases se fraksionuar per ne transportier, me nje skelet dhe dok te gomuar ne menyre qe pluhurat te mos perhapen ne menyre kaotike, sidomos ne kohe te thate dhe me erë.

- **Ndikimet ne uje**

Jane ujerat teknologjike ngaprocesi I prodhimit te betonit, te cilat dekantohen ne grope dekantuese pas dekantimit te tyre nga lenda e ngurte ne pezulli, i bashkohen rrjetit te kanalizimeve. Meqenese masa e perdorur eshte mase e gurit gelqeror, keto ujera nuk permbajne elemente qe mund te ndotin ujerat. Ujerat industrial qe perdoren ne linje, orientohen me nje kanal siperfaqesor ne sistemin e vecante.

- **Ndikimi ne ujerat siperfaqesore**

Ne territorin ku zhvillohet aktiviteti i karrieres se gurit gelqeror, zona eshte e thate. Megjithate duhet thene se gjate shfrytezimit dhe transportit, rritet masa e materialit te ngurte qe do te shpelahet nga ujerat rrjedhes siperfaqesore,vecanerisht gjate renies se reshjeve.

- **Ndikimi ne ujerat nentokesore**

Ekzistenca e nje pako te madhe te gelqerorit ben qe te mos kemi ndotje te ujerave nentokesore nga zhvillimi i ketij aktiviteti.

- **Ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e ngarkim- shkarkimit, sitat vibruese dhe impianti I betonit. Keto zhurma jane brenda normave te lejuara per mjedise pune 8 ore , megjithate shoqeria ka pajisur punetoret me mjete mbrojtese ndaj saj. Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe punohet vetem ne nderresen e pare e ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara prej linjes dhe mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth. Gjate punimeve ne objekt, ne impiantin e fraksionimit te gurit gelqeror do te kete nivele zhurmash, te cilat do te vijne si pasoje e punimeve ne keto objekte. Nivelet e zhurmave mund te arrijne nivelin me te larte prej 75dB, por per kohezgjatje relativisht te shkurter.

- **Ndikimet ne flore dhe ne faune**

- **Fauna**

Ndikimet negative mbi faunen do te jene te ndryshme mbi klasat e ndryshme te saj. Po ti referohemi pasurise se zones ne faune del se klasa qe ka ndikimete rendesishme eshte ajo e zvarranikeve, por specie qe do te preken nuk figurojne nder ato te rrezikuarat, te mbrojtura, endemike apo kercenuese. Nuk ka ndikime mbi gjitaret e territorit, per shkak te mungeses se tyre. Nje ndikim jo te konsiderueshem do te kete gjate shfrytezimit te zones, ne shpendet qe pushojne apo gjuajne ne territor.

- **Flora**

Ndikime real do te bjere mbi dheun dhe zhavoret ne siperfaqe, dmth demtim i habitatit te flores dhe direkt mbi vegjetacionin duke e larguar plotesisht ate nga territori qe do te shfrytezohet.

4. MASAT PER ELEMINIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Territorri perreth impiantit

I gjithe territori i subjektit dhe sheshet e levizjes jane te shtruara dhe te sistemuara. Nga shoqeria jane marre masa edhe per gjelberimin e territorit perreth impiantit duke bere te mundur mbjelljen me peme , gjithashtu nga stafi do tregohet kujdes per mbajtjen paster te ambientit dhe sperkatjen e tij here pas here me uje.

Menaxhimi i mjedisit

Objektivi I planit te menaxhimit eshte te minimizoje apo eleminoje ndikimet negative ne mjedis te cilat mund te rezultojne nga zhvillimi I aktivitetit. Plani I menxhimit duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

- Trajnim te punonjesve dhe masa te pergjithshme te mbrojtjes se mjedisit.
- Zbatim i udhezimeve per mbrojtjen dhe ruajtjen e bimesise dhe dherave siperfaqesore per te siguruar qe ky material te perdoret per mbulimin e zonave te zhveshura.
- Identifikimi i zonave te erozionit per shkak te punimeve te kryera dhe marrja e masave ndaj tyre
- Sigurimi qe mbetjet te trajtohen sipas planit te parashikuar.
- Sistemimi i materialeve ne vende te caktuara.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUZIONE

- ✓ Ne sheshin e impiantit te betonit do te behet ndarja e materialit ne fraksione te ndryshme dhe keto do te sistemohen ne shesh per tu derguar dhe perdorur neimpinatin e betonit.
- ✓ Uji i perdorur ne procesin e prodhimit te betonit me ane te kanalizimeve do te dergohet ne vasken e dekantimit nga ku do te behet ndarja nga sedimentet dhe perseri uji i pastruar kthehet ne proces nga e para.

REKOMANDIME

- ➢ Te kontrollohet periodikisht dhe te pastrohet gropa dekantuese. Mbetjet e ngurta qe ndodhen ne masen rreth 5% te perdoren per mbushje te territorit dhe krijimit te mjedisit te pershtatshem per mbjelljen e metejshme te pemeve dhe luleve.
- ➢ Te merren masa dhe te kryhet rehabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.
- ➢ Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te agregateve dhe mjeteve te transportit.
- ➢ Te kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen kanalet kulluse ne territor.

- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet pluhurave, zhurmave, vibrimet etj në jetën e tyre të përditëshme si dhe të merren masat e duhura për monitorimin në vazhdimësi të tyre me aparaturat dhe istrumentet e nevojshme.